

Transformimi i Gjelbër i Ndërmarrjeve Private në Kosovë (GPEK)

Transformimi i gjelbër po bëhet një
domosdoshmëri për biznesin e
NVM-ve në Kosovë.



GPEK është një projekt i Agjencisë
Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim (SDC), i
bashkëfinancuar nga Suedia dhe
i zbatuar nga Helvetas.



2026–2031

Një Partneritet Afatgjatë
për Zhvillim të Gjelbër



Pse tranzicioni i gjelbër është i rëndësishëm për NVM-të në Kosovë?



Tranzicioni i gjelbër po ndryshon ekonomitë dhe tregjet në mbarë botën.
Për NVM-të në Kosovë, ai paraqet sfida por njëkohësisht edhe mundësi të rëndësishme zhvillimi.



Ndryshimet globale

Rregulloret, standardet dhe kërkesat e tregut po bëhen gjithnjë e më të ashpra dhe po shndërrohen në norma të reja të biznesit.



Konkurrueshmëria në fokus

NVM-të që përshtaten me këto ndryshime do të rrisin konkurrueshmërinë e tyre dhe do të kenë qasje në tregje të reja. Ndërsa ato që mbeten pas rrezikojnë të humbin mundësi për zhvillim.



Kostot dhe qëndrueshmëria

Shfrytëzimi më efikas i resurseve dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme të prodhimit ulin kostot operative dhe forcojnë aftësinë e bizneseve për tu përballur me sfidat e ardhshme.



Punësimi dhe zhvillimi gjithëpërfshirës

Bizneset e gjelbra krijojnë vende pune cilësore dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.



E ardhmja e Kosovës


Përafrimi me agjendën e gjelbër të Bashkimit Evropian forcon rrugëtimin e Kosovës drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe me prosperitet.



GPEK ekziston për të ndihmuar ekosistemin e NVM-ve në Kosovë ta bëjë këtë tranzicion realitet, duke punuar për ekonominë, mjedisin dhe njerëzit.

Pse GPEK?


GPEK i përgjigjet sfidave të tranzicionit të gjelbër në Kosovë duke **forcuar ekosistemin mbështetës të NVM-ve.**



Si funksionon GPEK




GPEK lehtëson ndryshimin përmes ekosistemit që mbështet NVM-të.




Në përputhje me qasjen e Zhvillimit të Sistemit të Tregut, ne nuk i zëvendësojmë aktorët e tregut. Ne forcojmë ekosistemin që ndihmon NVM-të të rriten dhe të përshtaten.

Me kë bashkepunojmë



Tri rezultatet



Së bashku, këto rezultate krijojnë një ekosistem mbështetës ku NVM-të mund të zhvillohen në mënyrë të gjelbër, të jenë më të qëndrueshme dhe të gatshme për të ardhmen.

Fondi i Inovacionit



SFIDA

- Kosto të larta investimi.
- Qasje e kufizuar në financa.
- Aftësi e kufizuar e NVM-ve për të planifikuar dhe zbatuar investime të gjelbra.
- Ekosistem i dobët mbështetës.



NDËRHJRJA

- Grante në vlerë prej 50,000 – 100,000 €.
- Deri në 70% financim nga GPEK / minimum 30% bashkëfinancim nga NVM-të.



FOKUSI

- Zvogëlimi i rrezikut për të investuar.
- Mbështetja e inovacionit të gjelbër.
- Lehtësimi i transformimit të NVM-ve.
- Rritja e kërkesës për shërbime të gjelbra.
- Tërheqja e investimeve private.



Një mekanizëm bashkë-investimi i dizajnuar për të ulur rrezikun dhe për të nxitur investimet e gjelbra.

Thirrja për aplikim - së shpejti



AFATI KOHOR



- **Qershor-Korrik 2026** → Hapet thirrja për aplikim.



- **Dhjetor 2026** → Afati i fundit i shprehjes së interesit (EOI).



- **Sesione informuese**
Sesione online për pyetje-përgjigje dhe webinarë udhëzuese do të mbahen nga korriku 2026.



ÇFARË PËRFITOJNË NVM-të



- Ulje të kostove dhe rritje të efikasitetit.



- Qasje më të mirë në tregje, financim dhe shërbime të gjelbra.



- Rritje e konkurrueshmërisë.



NDIKIMI



- Rritje e investimeve të gjelbra.



- Replikim dhe zgjerim i zgjidhjeve të suksesshme të gjelbra.



- Ulje e emetimeve të gazrave serrë dhe përmirësim i efikasitetit të resurseve.



- Përmirësim i qëndrueshmërisë mjedisore përmes përdorimit më të gjerë të teknologjive të gjelbra.



- Më shumë vende pune dhe konkurrueshmëri më e lartë.



Nga aplikimi te investimi dhe replikimi në të gjithë tregun.

Ekipa e GPEK



Kreshnik Kurtishi
Menaxher i projektit



Rinora Gojani
Udhëheqëse për
informim të NVM-ve dhe
politika



Besnik Cecelia
Zëvendës menaxheri
projektit dhe
udhëheqës për
qëndrueshmërinë e
NVM-ve



Besa Ilazi Kastrati
Udhëheqëse për
inovacionin e NVM-ve



Valbona Rraci
Këshilltare për
inovacionin e NVM-ve



Edlira Pllana
Menaxhere e grantëve
të fondit të inovacionit



Fidan Kuraja
Udhëheqës për
monitorim dhe Matje të
Rezultateve



Ardi Mejzini
Udhëheqës për
Komunikim & KML



Rrona Vuçitërna
Zyrtare për
Administratë dhe
Operacione

- Një projekt
- Një ekip
- Vizion i përbashkët

Vizioni për ndryshime sistemike

EKOSISTEM MË I FORTË I INOVACIONIT TË GJELBËR

Inovacion, teknologji dhe
partneritete për
të ardhmen.



INFORMIM DHE DËSHMI MË TË MIRA

Të dhëna dhe njohuri
që nxisin vendimet.



SHËRBIME MË TË QËNDRUESHME PËR MBËSHTETJEN E BIZNESIT

Shërbime cilësore që
ndihmojnë NVM-të të
rriten në mënyrë të gjelbër.



QASJE MË E LARTË NË FINANCA

Financim më i përballueshëm
dhe i gjelbër për NVM-të.



POLITIKA MBËSHTETËSE

Politika që nxisin dhe
lehtësojnë rritjen
e gjelbër.



2031
NVM konkurruese,
të qëndrueshme ndaj
ndryshimeve klimatike
dhe inovative.

Një sistem tregu i qëndrueshëm që vazhdon të japë
rezultate edhe pas përfundimit të projektit.